



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (komision për dhënie mendimi)

Tiranë më, 3.11.2022

Dokument parlamentar

RAPORT **PËR** **PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”** (në parim)

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”, në mbledhjet e tij të datës 28 e 31 tetor dhe 1 e 3 nëntor 2022.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Laert DURAJ.

Gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2023, komisioni zhvilloi 4 seanca ku u njoh me projektbuxhetin në tërësi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, me projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me projektbuxhetin Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Komisioni u njoh me parashikimet e treguesit kryesorë të projektbuxhetit të vitit 2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë znj. Delina Ibrahimaj dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie. Mbledhja u zhvillua në datën 28 tetor 2022.

Ministria Ibrahimaj, u shpreh se projektbuxheti 2023 adreson sfida të rëndësishme për ekonominë shqiptare, si rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe rritja e çmimeve të konsumit, ndërkohë që si objektivi kryesor i politikës fiskale gjatë vitit 2023 do të jetë rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe ulja e stokut të borxhit publik.

Për vitin 2023, bazuar në skenarin mbi të cilin bazohet ky projekt-buxhet, parashikohet një rritje ekonomike reale prej 2.6%. Kjo rritje, parashikohet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, konsumi dhe investimet, por në një masë marginale pritet të kontribuojë pozitivisht edhe kërkesa e huaj neto, e mbështetur kryesisht nga rritja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve. Kjo rritje ekonomike e ngadalësuar ndikohet nga zhvillimet dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian.

Inflacioni i lartë i shkaktuar kryesisht nga goditja në ofertën globale të disa mallrave bazë ka qenë shqetësimi kryesor makroekonomik, edhe pse krahasuar me vendet e tjera të rajonit, apo me mesataren e BE-së, ka qenë dukshëm më i ulët. Kështu, inflacioni mesatar për periudhën janar-shtator 2022 ka qenë 6.4%, me vlerën më të lartë në muajin shtator prej 8.1%. Pritshmëria për inflacionin mesatar për të gjithë vitin 2022 është në intervalin 6.5% deri në 7%. Ndërkohë që parashikohet një normë mesatare inflacioni prej 3.6% për vitin e ardhshëm, me një tendencë rënëse gjatë vitit, për të arritur në rreth 3% në fund të vitit 2023.

Deri më tani, buxheti vazhdon të operojë me një suficit të përgjithshëm fiskal dhe stoku i likuiditetit të qeverisë është mjaft i bollshëm dhe i mjaftueshëm për të vazhduar një ekzekutim normal të buxhetit të vitit 2022, si dhe të vitit të ardhshëm. Kjo vlen jo vetëm në skenarin tonë bazë, por edhe në rastet e ndodhjes së skenarëve pesimistë afat-shkurtër në varësi të situatës që do të përjetojmë të ndikuar nga kriza ndërkombëtare.

Gjendja e financave publike është plotësisht nën kontroll dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë është duke i monitoruar në vazhdimësi në mënyrë që të parashikojë dhe zgjidhë probleme të ndryshme që mund të dalin, në mënyrë që të ruhet e pacënuar qëndrueshmëria e financave publike dhe stabiliteti makroekonomik i vendit.

Treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë të projektbuxhetit 2023 janë:

- Realizimi i rritjes reale të PBB-së në masën 2.6 %;
- Ruajtja e normës së Inflacionit në masën 3.6 %;
- Realizimin e të ardhurave në masën 29 % e PBB-së;
- Realizimi i shpenzimeve në masën 31.6 % e PBB-së;
- Mbjajtja e defiçitit buxhetor në masën minus 2.6 % e PBB-së;
- Uljen e Borxhit Publik në masën 67.5 % e PBB-së;
- Realizimi i investimeve publike në masën 5.5 % e PBB-së; si dhe
- Mbjajtjen e normës së papunësisë në masën 10.2 % e PBB-së.

- ***Të ardhurat***

Programimi i të ardhurave për vitin 2023, mbështet synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rritjen e të ardhurave, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në faktorët që do të impaktojnë këtë periudhë dhe risqet e mundshme që mund të shfaqen, si dhe në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

Rimëkëmbja e vazhdueshme ekonomike dhe inflacioni i lartë mbështetën rritjen e të ardhurave buxhetore dhe ngushtimin e deficiteve fiskale për tremujorin e parë të vitit 2022, ndërkohë që raporti i borxhit publik ndaj PBB-së u ul në krahasim me fundin e vitit 2021.

Të ardhurat buxhetore në raport me PBB-në parashikohen të qëndrojnë konstante në terma realë në periudhën 2023-2025 në vlerën 28.4% të PBB-së, që përfaqëson një përqindje më të lartë krahasuar me mesataren prej 27.1% të PBB-së të realizuar gjatë periudhës 2019-2022.

Në vitin 2023, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 625.7 miliardë lekë. Nga këto, të ardhurat tatimore 587.8 miliardë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat 431.2 miliardë lekë, ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 126.5 miliardë lekë. Pritet që të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit të rriten 7.7 %, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat programohen të rriten 8%.

- **Shpenzimet**

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2023 është planifikuar 687.2 miliardë lekë ose 31.6% e PBB-së, me një rritje në vlerë absolute prej 26.5 miliardë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2022.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2023-2025 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike prej mesatarisht 5.2% të PBB-së duke u përqendruar në financimin e projekteve me rëndësi strategjike.

Shpenzimet e planifikuara synojnë mbështetjen për digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike; finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale; sigurinë kombëtare; mbështetjen e sektorit të ujit; shëndetësisë; arsimit; si dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Parashikohet që rreth 9% e shpenzimeve të përgjithshme publike t'i dedikohen politikave publike me bazë gjinore të përfshira në 47 programe buxhetore. Edhe për vitin 2023 shpenzimet buxhetore do të vijojnë të orientohen drejt arritjes dhe ruajtjes së standardeve të kërkuara në fazën e tanishme optimiste të procesit të integritit të vendit në Bashkimin Europian.

Investimet Publike për vitin 2023 janë planifikuar në masën 5.6% e PBB-së ose 122.2 miliardë lekë, përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit. Në planifikimin e investimeve për vitin 2023 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj. Ashtu si në vitin 2022, edhe në vitin 2023 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim.

- **Defiçiti buxhetor**

Defiçiti buxhetor për vitin 2023 parashikohet të ulet në nivelin 2.6% të PBB-së, dhe synohet një trend rënës deri në vitin 2025 duke përmbushur kështu objektivin madhor të Qeverisë për uljen graduale të stokut të borxhit publik.

- **Borxhi publik**

Borxhi publik bruto do vijojë trajektoren rënëse të nisur që në vitin 2021 në përputhje me rregullin respektiv fiskal. Në vitin 2022 pritet që borxhi publik të bjerë në rreth 68.8 përqind të PBB-së dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth 67.5% në vitin 2023. Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 64.4 përqind në vitin 2026 dhe më tej në rreth 55 përqind në vitin 2031.

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2022 dhe gjatë vitit 2023, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje, duke mbajtur në konsideratë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit, kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm, në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve.

Për realizimin e këtij objekti:

- në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër do të synohet refinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet, ndërsa nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar;
- në tregun e huaj, burimet kryesore të huamarrjes do të jenë huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur qeverinë për reformat e politikat zhvillimore të vendit;

Gjithashtu, në rast se kushtet e tregut do të jenë të favorshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2023 synon daljen në tregjet ndërkombëtare financiare nëpërmjet emetimit të instrumentit të Eurobondit.

- **Buxheti vendor**

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2023 janë parashikuar në masën 65.5 miliardë lekë, me një rritje prej 9% më shumë se buxheti i vitit 2022.

Mbështetja që ka dhënë qeveria për njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet reformave të ndërmarra, pasqyrohet në rritjen e transfertës së pakushtëzuar, e cila në krahasim me vitin 2022 është rritur në vlerën 3 miliardë lekë, ose 16.1% më e lartë.

Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2023, prej 21.7 miliardë lekësh, do të shtohen edhe fondet prej 9.8 miliardë lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja. Në total, në vitin 2023, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 31.5 miliardë lekë.

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në mbledhjen e datës 31 tetor 2022. Ministria Znj. Mirela Kumbaro prezantoi projektbuxhetin e kësaj ministrie, duke paraqitur programet kryesore të saj, si dhe iu përgjigj interesit të deputetëve në lidhje me problematika të ndryshme të mjedisit dhe turizmit dhe buxhetimin e këtyre dy sektorëve.

Në total buxheti i kësaj ministrie është rreth 2.3 miliardë lekë dhe ka një zbritje me rreth 6 % ose me 136.86 milionë lekë në krahasim me buxhetin e vitit 2022. Kjo për shkak të përfundimit të disa programeve në sektorin e turizmit.

• TURIZMI

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale. Prioritet për periudhën 2022-2024 mbetet diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor.

Shqipëria në 30 shtator arriti 6.428.665 milionë turistë, që përbën një shifër më të lartë se ajo e të gjithë vitit 2019 që ishte viti më i mirë, dhe 31% më shumë se sa gjithë viti 2021. Zhvillimi i turizmit nuk ka të bëjë vetëm me rritjen e shifrave turistike dhe prurjen e flukseve më të larta të të ardhurave ekonomike. Kjo ka të bëjë me zhvillimin e burimeve turistike, infrastrukturës, produkteve dhe atraksioneve, por ka të bëjë gjithashtu edhe me një shoqëri, politikë dhe ekonomi që përballet me sfidat e globalizimit.

Qëllimi primar i politikës turistike është të paraqesë parimet drejtuese mbi të cilat do të bazohet vendimmarrja dhe çështjet e tjera që lidhen me turizmin në Shqipëri, si dhe kuadrin brenda të cilit do të formulohet aktiviteti turistik i Shqipërisë në vitet e ardhshme.

Riformulmi i kësaj politike synon të përfshijë planifikimin dhe zbatimin e një strategjie të përbashkët me operatorë dhe entitete bashkëvepruese për menaxhimin e organizuar të destinacioneve, propozimin dhe kryerjen e aktiviteteve promovuese me interes të ndërsjellë për të gjitha subjektet e turizmit brenda dhe jashtë vendit, si dhe ngritjen e cilësisë së përgjithshme të të gjithë gamës së shërbimeve turistike që ofrohen në vend. Për të përfituar sa më shumë nga destinacioni e nga qasja e përfitimit dhe qëndrueshmërisë, është e nevojshme të planifikohen dhe zhvillohen produktet e përshtatshme turistike.

Deri tani ka munguar një sistem i dedikuar i përpunimit të të dhënave për sektorin e turizmit, praktikisht më i rëndësishmi i zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe është punuar me mbledhje të dhënash kryesisht nga INSTAT dhe Banka e Shqipërisë, dhe nga informacione të mbledhura pranë bashkive apo institucione të tjera qendrore dhe vendore. Për këtë arsye në fokus, do të jenë platformat të cilat sigurojnë të dhëna statistikore të besueshme dhe të matshme dhe që japin mundësinë e analizimit të këtyre treguesve, si një bazë e mirë mbi të cilat do të mbështetet zhvillimi i mekanizmave ligjore dhe strukturore për vitet e ardhshme.

Znj. Kumbaro sqaroi se në bashkëpunim me FSHZH-në po përgatitet një sistem elektronik i statistikave të turizmit në Shqipëri, Sistemi i Databazës Së Statistikave të Turizmit. Ky sistem do t'i shërbejë si përdoruesit normal, vizitor, nëpunës, gazetar, ashtu edhe sektorit të biznesit e analistëve ekonomikë, të ndara sipas sektorë të ndryshëm të këtij aktiviteti ekonomik kaq të rëndësishëm për vendin.

Me ndërveprimin dhe mbështetjen e partnerëve të rëndësishëm, do të vijojë puna për hartëzimin dhe inventarizimin e itinerarve turistike me interes të shtuar, atë të turizmit malor, shtigjeve, ciklizmit, hiking si dhe njësisive të tjera pritëse dhe akomoduese, të cilat impaktojnë e gjithmonë e më pozitivisht mjedisin dhe natyrën.

Promovimi dhe prezantimi i Shqipërisë si një “destinacion turistik” në mbarë botën do të përmbushet dhe aplikohet nëpërmjet një game të gjerë mjetesh dhe metodash, sa inovative aq edhe të qëndrueshme. Kështu, nëpërmjet fondit për zhvillimin e programeve në Turizëm do të financohen rreth 20 projekte/platforma zhvillimore dhe të qëndrueshme në të mirë të natyrës dhe krijimit të produkteve turistike, të sipërmarrjes inovative dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore për një shërbim më të mirë turistik, të standartizuar dhe gjithëvjeter.

Projektet vjetore do të synojnë promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike, nëpërmjet zhvillimit të turizmit malor, natyror dhe kulturor, turizmit kulinar, ekoturizmit, turizmit nostalgjik, turizmit të aventurës, në funksion të realizimit të misionit strategjik: *“Shqipëria, një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit”*.

Rritja e llogarive korente në programin e turizmit me rreth 78 milionë lekë ka ardhur si rezultat i fondit të projekteve të turizmit që Ministria ka shpërndarë gjatë viteve të mëparshme, të cilat ishin planifikuar në investime në zërin hartim projekte llog. 230, dhe këtë vit këto shpenzime futen në llogarinë ekonomike 604 (transfera të brendshme).

Një nismë dhe strategji prioritare për vitin 2023, do të jetë edhe zgjerimi i ofertës turistike nëpërmejt zhvillimit të turizmit të takimeve, stimujve, konferencave dhe ekspozitave, duke e bërë Shqipërinë qendrër të kongreseve dhe bashkëorganizatore të forumeve të eventeve të rëndësishme të industrisë së turizmit global.

Po kështu për vitin 2023 për anëtarësimet në organizatat ndërkombëtare është parashikuar një vlerë prej 20 milionë lekësh në bazë të marrëveshjeve dhe detyrimeve përkatëse.

Investimet Kapitale për vitin 2023 kanë një ulje prej 28%, e cila ka ardhur si rezultat i sistemimit të fondit të projekteve të turizmit nga llogaria 230 (investime) në llogarinë 604 transfera të brendshme (shpenzime korente), si dhe uljes së tavanit në total me 80 milionë lekë. Përqindja e shpenzimeve kapitale për vitin 2023 kundrejt totalit të buxhetit është 18.2 %.

Nxitja e Investimeve në Turizëm do të fokusohet kryesisht tek:

- Rritja e cilësisë dhe standardeve në turizëm, nëpërmjet operimit të brandeve ndërkombëtare 4 - 5 yje, nxitur nga një sistem incentivash, duke synuar dhënien e statusit “*Investitor në strukturë akomoduese 4 - 5 yje status special*”, për të paktën 4 struktura akomoduese me rreth 1000 shtretër;
- Bashkëpunim për të siguruar dinamizmin e proceseve mbështetëse për më shumë se 10 projekte të shpallura “*Investitorë strategjikë*”, me vlerë prej rreth 1 miliard euro që po injektohen nga sektori privat (mediterranean, finsec, omnix);
- Operimi i shërbimeve me vlerë të veçantë lokale si agroturizëm duke lehtësuar kriteret rregullatore;
- Rritja e inventarit të strukturave akomoduese nga 1500 në 2000 struktura të kategorizuara, në vitin e fundit, duke dinamizuar procesin e kategorizimit, respektivisht duke formalizuar ato, si dhe duke rritur kontributin në të ardhurat tatimore dhe në përmirësimin e shërbimeve;
- Fushata komunikuese informimi, shoqëruar me kontrole nga Inspektoriati për turizmin, lidhur me klasifikimin e strukturave në përputhje me kushtet, kriteret, afatet dhe procedurën ligjore;
- Koordinimi i procesit të respektimit të kushteve dhe kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, nëpërmjet përgatitjes së listës së plazheve, dhe hartës për stacionet e plazhit dhe plazhit publik propozuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim arritjen e standardeve në menaxhimin e tyre, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe sigurisë së jetës.

• MJEDISI

Për fushën e Mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Prioritetet për mjedisin janë programe që shkojnë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tij.

Prioritetet që synohen të përmbushen me anë të financimeve për vitin 2023 janë:

I. Menaxhimi efektiv dhe qeverisja e Zonave të Mbrojtura nëpërmjet:

- Hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura;
- Përgatitjes së plotë të paketës ligjore dhe zbatimit efektiv të saj, që do të mbështesë menaxhimin efektiv dhe do të garantojë fuqizimin e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e stafit të Zonave të Mbrojtura;
- Investimeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe unifikimin e Zonave të Mbrojtura në të gjithë territorin;
- Vlerësimit të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, propozimit për krijimin e zonave të reja dhe rritjen e sipërfaqes së tyre në përputhje me objektivat globale “*Post 2020*”, si dhe menaxhimit të integruar të tyre;

Aktualisht zonat e mbrojtura zënë 21% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të vendit. Vitet e fundit këto zona po tërheqin gjithnjë e më shumë vizitorë, vendas apo të huaj, duke arritur në mbi 4 milionë në vitin 2021 dhe duke u rritur me 15% në vitin 2022.

II. Financimi i qëndrueshëm i Zonave të Mbrojtura nëpërmjet:

- Mbështetjes së zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në territoret e Zonave të Mbrojtura, sipas kërkesave të legjislacionit dhe standarteve ndërkombëtare;
- Sigurimit të një koordinimi më të mirë dhe më me efektivitet me donatorët, për të rritur efektivitetin dhe sinergjinë e ndërhyrjeve.

III. Komunikimi dhe rritja e ndërgjegjësimit

Në procesin e mbrojtjes së natyrës në vend është me rëndësi të madhe që Zonat e Mbrojtura të jenë të njohura dhe të vlerësuara nga publiku i gjerë dhe nga grupet e interesit. Në këtë kuadër synohet të realizohen:

- Aktivitete të fokusuara në vizibilitetin e Zonave të Mbrojtura nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias dhe prezencë të vazhdueshme në këto rrjete;
- Pasqyrimi dhe promovimi i aktiviteteve dhe punës së administratës së Zonave të Mbrojtura në media;
- Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promovuese mbi vlerat, rëndësinë dhe potencialin turistik të Zonave të Mbrojtura;
- Edukimi mjedisor me nxënësit e shkollave dhe komunitetet përreth Zonave të Mbrojtura, duke e bërë prezent konceptin e Zonave të Mbrojtura dhe potencialet që ato mbartin.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Në kuadër të fushës së veprimtarisë së saj Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë vitit 2023 do të ketë në fokus të politikave dhe nismave të saj programe dhe procedura, të cilat lidhen me:

- Reduktimin e përdorimit të plastikës njëpërdorimëshe;
- Krijimin e një sistemi për kthimin dhe mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të plastikës, aluminit dhe qelqit;
- Rritjen e nivelit të saktësisë matjes të cilësisë së ajrit urban dhe propozimit të masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit nëpërmjet rikonstruksionit dhe vënies në punë të stacioneve të ajrit eksiztuese dhe blerjes së stacioneve të reja;
- Krijimin e infrastrukturës për matjen dhe vlerësimin e zhurmave urbane dhe industriale dhe propozimin e masave për uljen e nivelit të zhurmave që gjenerohen nga aktivitetet ekonomike të licensuara. Rishikimi i ligjit të zhurmave dhe planit kombëtar të zhurmave dhe planet vendore;
- Krijimi i sistemit elektronik të raportimit të të dhënave të vetemonitoruara nga subjektet e pajisur me leje mjedisi në bashkëpunim me AKSHI-në;
- Krijimi i një sistemi kontrolli dhe bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e gjendjes në mjedis duke orientuar gjeneruesit e mbetjeve të bëjnë trajtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

• DISKUTIMET NË KOMISION

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2023 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, u përqëndruan kryesisht tek:

- Ulja e fondeve të këtij projektbuxheti në raport me buxhetin e vitit 2022 për dy fusha prioritare siç janë mjedisi dhe turizmi;
- Menaxhimi i mbetjeve në qarqe të caktuara dhe transferimi i fondeve të mjaftueshme për përmbushjen e kësaj kompetence nga bashkitë;
- Qasja e Ministrisë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe me çështjen e incenerimit të tyre;
- Barazia e shpërndarjes së investimeve kryesisht atyre që lidhen me turizmin në të gjithë vendin;
- Ndotja akustike dhe dobësitë e legjislacionit për zgjidhjen e kësaj çështjeje shqetësuese për qytetarët;
- Administrimi i zjarreve dhe investimet në ripërtëritjen e pyjeve të dëmtuara nga zjarret;
- Investimi në infrastrukturë, menaxhimi dhe mbikqyrja e zonave të mbrojtura dhe promovimi i tyre si atraksione turistike dhe ndërhyja e nevojshme në disa prej tyre;
- Menaxhimi më i mirë i shfrytëzimit të plazheve dhe infrastrukturës në to; etj.

Ministria Kumbaro, iu përgjigj shqetësimeve të deputetëve duke dhënë detaje në lidhje me çështjet e ngritura prej tyre.

- Në lidhje me menaxhimin e mbetjeve ajo sqaroi se ka nisur plani i pastrimit të Shqipërisë, duke filluar që nga qytetari e deri në pikën fundore të tyre. Në lidhje me incenerimin ajo sqaroi se sipas Startegjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, 3 janë metodat e trajtimit të tyre që janë landfill-et (metodë e kufizuar në kohë 10-20 vjet dhe zënia e sipërfaqeve të mëdha të tokës), inicineratorët ku mbetjet digjen për të prodhuar energji apo avull, dhe teknologjia e biomasës që është shumë e përparuar por edhe shumë e kushtueshme. Të treja këto mënyra parashikohen edhe në legjislacionin e BE-së. Trajtimi i mbetjeve në raport me vitin 2013 është rritur shumë duke kapur masën 90% të trajtimit të tyre. Landfillet janë disa në Shqipëri por zënë sipërfaqe të mëdha toke. Duhet shkuar drej ekonomisë qarkulluese duke promovuar ndalimin e përdorimit të plastikës njëpërdorimëshe, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre.
- Në lidhje me ndotjen akustike dhe legjislacionin përkatës sqaroi deputetët se ligji aktual ka probleme me përplasjen e kompetencave mes institucioneve dhe po punohet për një legjislacion të ri. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si një nga dy institucionet kryesore për vleresimin e zhurmave industriale, matjen dhe kontrollin e tyre pergjatë vitit 2023 do të pajiset me aparatët për matjen e zhurmave duke i dhënë tashmë zgjidhje një problematike, e cila për shumë vite ka qenë në një ngërç institucional dhe ku subjektet e dëmtuara shpesh nuk gjenin rrugen ligjore për të trajtuar shqetësimet e tyre në lidhje me këtë problematikë.
- Për sa i takon problematikave në zonat e mbrojtura dhe investimeve në to, Znj. Kumbaro u shpreh se në kuadër të zbatimit të politikave për menaxhimin efektiv të Zonave të Mbrojtura, AKZM ka nisur procesin për hartimin e Planeve të Integruara të Menaxhimit si dokumenti bazë për ruajtjen dhe zhvillimin e një Zone të Mbrojtur, duke synuar harmonizimin maksimal të kërkesave ligjore për menaxhimin efektiv të tyre.
- Gjithashtu, në lidhje me menaxhimin e stacioneve të plazhit ajo sqaroi se ka dalë tashmë Vendimi i Këshillit të Ministrave për vitin 2023, si dhe ka mbaruar gjithë sistemi i hartëzimit të stacioneve

të plazheve publike dhe për menaxhim të përkohshëm. Në datë 1 nëntor fillon aplikimi deri në 30 nëntor.

Në përfundim të diskutimeve Znj. Kumbaro kërkoi mbështetjen e komisionit për disa rregullime të brendshme buxhetore, të cilat do të sillnin një efektivitet më të mirë të fondeve të alokuara në përmbushje të misionit të kësaj Ministrie në fushën e turizmit dhe mjedisit.

- 1- Në llogarinë 600 dhe 601, nga përlogaritjet për zërin paga e sigurime shoqërore, mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikës së MTM dhe në bazë të ristrukturimit të kërkuar të organikës të të gjithë strukturës së MTM-së, të bëhen ndryshimet si më poshtë të detajuara në nivel programi dhe llogarie ekonomike:

Llogaria 600

a. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”	83,490,000 lekë
b. “Administrimi i Pyjeve”	253,100,000 lekë
c. “Zhvillimi i Turizmit”	112,200,000 lekë
d. “Mbrojtja e Mjedisit”	279,000,000 lekë
Totali i llogarisë 600	727,790,000 lekë

Llogaria 601

a. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”	13,600,000 lekë
b. “Administrimi i Pyjeve”	42,100,000 lekë
c. “Zhvillimi i Turizmit”	18,600,000 lekë
d. “Mbrojtja e Mjedisit”	46,500,000 lekë
Totali i llogarisë 601	120,800,000 lekë

Totali i llogarisë 600 dhe 601 **848,590,000 lekë**

- 2- Në shpenzimet kapitale, në programin “Administrimi i Pyjeve”, të bëhet ndryshimi brenda llogarive të investimeve, konkretisht në llogarinë 231 (investime) të zbriten 53,350,000 lekë dhe në llogarinë 230 (hartim projekti) të shtohet kjo vlerë prej 53,350,000 lekë.
- 3- Në shpenzimet kapitale, në programin “Administrimi i Pyjeve”, në bazë të buxhetit të propozuar, është parashikuar për vitin 2023 një vlerë prej 102,900,000 lekë për Zbatim Projekti “Ngritja e Infrastrukturës me theks tek ajo Ujore Eko-Park Ulza” dhe në vijim kërkohet shtesë fondi për diferencën prej 203,900,000 lekë, respektivisht për vitin 2024 vlera shtesë 101,950,000 lekë dhe për vitin 2025 vlera shtesë 101,950,000 lekë, për të patur të mbuluar vlerën totale të projektit rreth 500,000,000 lekë (projekti i zbatimit përfundon në dhjetor të këtij viti).

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në mbledhjen e datës 1 nëntor 2022. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministria Znj. Frida Krifca. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Në këtë vit të vështirë me kosto të larta për inputet dhe naftën sektori i bujqësisë ka treguar stabilitet dhe qëndrueshmëri. Bujqësia ka qenë sektori që është parë me përparësi të veçantë në mbështetje të prodhuesve dhe përpunuesve për lehtësimin e kostove të imputeve, garantimin e tregjeve të importit apo mbështetje të kredive për procesin e tyre prodhues.

Shkëmbimet tregtare të produkteve bujqësore kanë patur një zhvillim të konsiderueshëm. Rritja e qëndrueshme e eksporteve bujqësore është bazuar në orientimin dhe mbështetjen e prodhimit drejt produkteve me avantazhe krahasuese dhe konkurruese, në përmirësimin e infrastrukturës rurale, përmirësimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, etj.

Në vitin 2022 bujqësia është mbështetur me nivelin më të lartë të fondit gjatë 30 viteve të fundit, me 4.9 miliard lekë, dhe duke e rritur me 50% krahasuar me fondin e miratuar në fillim të vitit. Po mbështeten dhe do të vijojë mbështetja për 41 mijë fermerë nga skemat e ndryshme me një buxhet prej 7.1 miliardë lekësh. Konkretisht:

- Skema Kombëtare e Naftës: 34,630 fermerë me buxhetin total 1.95 mld, për 126,765 ha tokë.
- Skema e mbështetjes në bujqësi: rreth 6600 përfitues për një fond 2.573 miliardë.
- Skema e trajnimit në bujqësi: Rreth 3000 mijë fermerë dhe specialistë të sektorit të trajnuar sipas parashikimeve, për një fond prej 50 milionë lekësh.

Është miratuar Regjistri i Fermerit, ku secili fermer do të regjistrojë përdorimin e çdo pesticidi, sasinë, kohën dhe gjurmueshmërinë e tyre për çdo kulturë dhe deri tani janë shpërndarë rreth 3 mijë regjistra, me një vëmendje të shtuar për fermerët që synojnë prodhimin për eksport.

Angazhimi për vitin aktual ka qenë i madh për të përmbyllur me sukses disa ndërhyrje të rëndësishme në sektor si:

- Finalizimi i dy dokumentave bazë, ai i Politikës Kombëtare të Sigurisë Ushqimore dhe Plani 10-vjeçar për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve ;
- Garantimi që në Shqipëri të tregtohen vetëm pesticide apo produkte të mbrojtjes së bimëve të regjistruara ne Bashkimin European, duke respektuar fazat tranzitore;
- Përmbyllja e reformës së veterinarisë, duke shtuar në terren rreth 400 veterinerë dhe agronomë të rinj dhe duke siguruar një mbulim efektiv e të plotë të territorit. Me ndërhyrjet e fundit në strukturën e AKVMB-së është siguruar zinxhiri i kontrollit në çdo fermë, treg blegtoral dhe thertore;
- Forcimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV-it ka qenë prioritet duke përfunduar përmirësimin infrastrukturor sipas standardeve evropiane të biosigurisë.

Prioritetet për bujqësinë janë rritja e eksporteve, garantimi i sigurisë ushqimore, turizmi rural, digjitalizimi dhe inovacioni, peshkimi.

Për vitin 2023 është parashikuar fillimi i projektit “Mbështetje për zhvillimin e tregjeve dhe prodhimitarisë detare (Ekonomia Blu)”.

Për bujqësinë shqiptare, Buxheti i vitit 2023 do të jetë buxheti i sigurisë në terma të nivelit të prodhimit dhe i vazhdimësisë së zhvillimit të sistemeve tona prodhuese dhe kapaciteteve eksportuese, të rritjes së fuqisë konkurruese në tregjet rajonale dhe më gjerë.

Ky Projektbuxhet është planifikuar në total në 14.2 miliardë lekë për bujqësinë, me një rritje prej 12% në krahasim me vitin 2022, përmes të cilit synohet të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm i bujqësisë dhe i zonave rurale, të peshkimit dhe ekonomisë blu dhe të zhvillimit të kapaciteteve administrative dhe institucionale, bashkëpunimin e aktorëve, inovacionin dhe digjitalizimin.

Investimet në bujqësi për vitin 2023 synojnë të nxisin prodhimin bujqësor dhe blegtoral, duke reduktuar koston dhe duke rritur konkurrueshmërinë, duke vijuar menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja dhe duke ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur konsumatorin përmes sigurisë ushqimore.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mësipërme sipas programeve të mëposhtme:

- **Zhvillimi rural dhe mbështetja për fermerin**

Programi Zhvillimi Rural, ku përfshihen edhe skemat mbështetëse të fermerëve me subvencione dhe përfshihet edhe shpërndarja e naftës pa detyrime fiskale për përdorim në bujqësi për fermerët. Mbështetja më e lartë e dhënë ndonjëherë në bujqësi, do të shkojë vetëm për zhvillimin rural me 8.7 miliardë fonde nga 7.1 miliardë të buxhetit fillestar të vitit 2022.

- *Mbështetja nëpërmjet Skemës Kombëtare*

Mbështetja nëpërmjet Skemës Kombëtare me 1.98 miliardë lekë, duke synuar e zvogëlimin e koston së prodhimit, rritjen e sipërfaqes së kultivuar, si dhe rritjen e eksporteve, kryesisht të prodhimeve nga serrat. Ky fond pëson një rënie me 12%, me rreth 2000 përfitues më pak në 2023. Përfitues nga këto masa mbështetëse do të jenë rreth 41 mijë fermerë. Mbështetja nëpërmjet Skemës së naftës falas për punimet e mekanizuara me 1.32 miliardë lekë. Kjo skemë ka rritje në vlerë dhe në objektivat afatshkurtër do të ketë një rritje të përfituesve nga rreth 34.800 përfitues në vitin 2022, në rreth 38.000 në vitin 2025, por për vitin 2023 do të jetë 24000 fermerë.

Gjithashtu, nëpërmjet Skemës Kombëtare të Trajnimit, që aplikohet për herë të parë, në përgjigje të nevojave të vazhdueshme me fermerë, agropërpunues për përmirësimin e mbështetjes në njohjen e teknikave të reja të prodhimit, zhvillimet e tregjeve, të cilat do t'i mundësonin të korra më të mbara dhe

të ardhura më të larta. Ky Program i cili po ndiqet nga 573 ekstensionistë dhe specialistë të bujqësisë do të kthehet në një instrument të përvitshëm trajnimi për specialistët e bujqësisë në të gjithë vendin.

- *Mbështetja nëpërmjet Programit IPARD*

Mbështetja nëpërmjet Programit IPARD me 3.9 miliardë lekë financim i huaj dhe bashkëfinancim ku përfitues janë 200 subjekte.

Nëpërmjet këtij programi vijohet të dedikohet financim për:

- Rritjen e eksporteve, për produktet potenciale, nëpërmjet nxitjes së produktivitetit duke mbështetur dhe financuar rritjen e sipërfaqes së serrave, fuqizimin e fermave të mëdha, forcimin e agropërpunimit, rritjen e mekanizimit, si dhe teknologjitë inovative;
- Rritje e produktivitetit nëpërmjet orientimit drejt kulturave të kërkuara nga tregjet ndërkombëtare dhe me mekanizim, si dhe mbështetjen e drejtpërdrejt me naftë pa akcizë duke ndikuar në rritjen e sipërfaqes së prodhuar. Synohet një rritje me 15%, sipërfaqen e serave dhe 10% më shumë sipërfaqen e kultivuar me grurë;
- Mbështetje për agropërpunuesit për fuqizimin e kapaciteteve dhe linjave përpunuese dhe përmirësimin e infrastrukturës duke i shtuar vlerë produktit primar në vend;
- Incentiva për të çuar kapital dhe investime në fshatrat e Shqipërisë nëpërmjet investimeve në infrastrukturën dhe shërbimet e turizmit rural me fokus të posaçëm gratë, të rinjtë dhe shqiptarët që jetojnë jashtë dhe duan të investojnë në vendlindjen e tyre në fshat;
- Mbështetje për inovacionin dhe digjitalizimin duke inkurajuar të rinjtë të ndërtojnë start-up në shërbim të bujqësisë së zhvilluar.
- Mbështetje për sektorin e blektorisë në mënyrë thelbësore me masa të cilat nga njëra anë synojnë rritjen numrit të krerëve nëpërmjet organizimit të tyre në ferma më të mëdha blektorale dhe nga ana tjetër rritjen e nivelit të formalizimit në sektor. Edhe këtë vit për të ruajtur vijueshmërinë e skemave, do të vazhdojë mbështetja për krerë si për gjedhin edhe për të imtat.

- **Siguria Ushqimore**

Në vitin 2023 buxheti për sigurinë ushqimore do të jetë rreth 2 miliardë lekë.

Buxheti i shtetit në vazhdimësi mbështet me buxhet vaksinimin për sëmundje të tuberkulozit, plasjes, aftës epozotike, gjuhës blu, etj, duke përjashtuar vaksinën e tërbimit, e cila kërkohet me insistim nga BE-ja që të kalojë nga buxheti i BE-së në buxhetin e shtetit shqiptar. Gjithashtu, mbështetet edhe matrikullimi i kafshëve në nivel kombëtar, si një nga hallkat kryesore të gjurmueshmërisë në zinxhirin e produkteve shtazore.

Buxheti i vitit 2023 parashikon të përfshijë të gjitha fazat e survejancave për brucelozën, murtajën afrikane të derrave dhe gripin e shpëndëve, që nga monitorimi në fermë, mostrimi, analizimi në laboratorët rajonal të AKU-së dhe ato të ISUV-it.

Gjatë vitit 2023 do të kryhen 12 validime metodash për 12 grupsubstancash për mbetjet e antibiotikëve në produktet shtazore të eksportit (peshk dhe vezë).

Viti 2023 do të jetë sfidë për akreditimin edhe të 12 metodave duke e cuar në total 118 metoda të akredituara nga 106 që u arrit deri në 2022-in.

Në vitin 2023, do të mbështetet reformimi i ISUV-it, edhe përmes një rritjeje të nivelit të pagave për stafin me një fond total shtesë prej 30 milion lekë.

Parashikohet ngritja e infrastrukturës së laboratorit të shëndetit të bimëve 2023. Stafi ka filluar trajnimet gjatë vitit 2022 për të përballuar menaxhimin e këtij laboratorit.

Zbatimi i fletores së fermerit duke filluar nga korriku i këtij viti do të vazhdojë të zgjerohet dhe do të kalojë nga mbështetja e fazës së parë nga projekti i sigurisë ushqimore të financuar nga BE-ja, me mbështetje të buxhetit të shtetit dhe është planifikuar që gjatë vitit 2023 për serat të zgjerohet trajnimi dhe shpërndarja e fletores së fermerit për të gjithë nënsektorët e bujqësisë. Ky instrument do të realizojë kontrollin e përdorimit të pesticideve duke ulur riskun e gjetjeve të mbetjeve të pesticideve në produktet e hedhura në treg dhe të eksportuara.

- **Peshkimi**

Programi Mbështetje për peshkimin me një buxhet prej 403 milionë lekë, me një ulje prej 43% në krahasim me vitin 2022. Kjo për shkak të mbylljes së projektit “Dokumenti Sektorial për Peshkimin (IPA II) Mbështetje për sektorin e peshkimit” dhe projekti “Furnizimi me pajisje peshkimi - IPA 2016”. synohet të kryhen investime si:

Buxheti i planifikuar do të sigurojë:

- Shtim të kapacitetit ankorues në Portin e Durrësit që do të lehtësojë procedurat e zbarkimit të produkteve peshkore të anijeve të peshkimit;
- Ndërtim të tregjeve të reja për produktet peshkore do të rrisin sasinë, cilësinë, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e këtyre produkteve duke i bërë ato më atraktive si në tregun e brendshëm, ashtu dhe për tregjet ndërkombëtare;
- Përditësim të softëear-it të Regjistrisë të Anijeve të Peshkimit, sipas standardeve të Bashkimit Europian, duke rritur sigurinë dhe kapacitetin e softëear-it.

Investimet në programin e peshkimit synojnë rritjen e prodhimit të produkteve peshkore me 10-20% dhe eksportet në masën 60-70%;

- **Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit**

Ky program është tejet i rëndësishëm dhe këtë vit mbështetet me 2.1 miliardë lekë, ose 28% më shumë se viti 2022. Dy shtyllat kryesore të programit janë:

- Rehabilitimi i kanaleve ujitës me një fond total prej 337 milion lekë, i cili do të përmirësojmë ujitjen në rreth 12.000 ha. Ndërhyrjet janë të shumta, në hapësira të ndryshme të territorit, veçanërisht në rajonin veri-perëndimor dhe në Shqipërinë e Mesme. (*Kanale Ujitës Peqin-Kavajë, Mat-Lezhë, Shkodër, Bërdice, Gjançi, Polis-Tudan*)
- Investime në infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja nëpërmjet rehabilitimit/ndërtimit të argjinaturave mbrojtëse me një fond total prej 738 milion lekë. Ku do të rehabilitohen ose ndërtohen rreth 22 km argjinatura për mbrojtjen nga gërryerja dhe përmbytja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara, më të ekspozuara nga rreziku i përmbytjeve lumore, kryesisht në lumenjtë Buna, Vjosa, Osum, Shkumbin, Devoll, Erzen, etj.

Gjithashtu, do të përfundojmë rikonstrukcioni i plotë i hidrovorit të Akërnisë për rritjen e sigurisë së kullimit në rreth 4.600 ha tokë në fushën e Akërnisë, territor brenda të cilit përfshihet edhe ndërtimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.

- **Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor**

Qëllimi i këtij programi është përmirësimi i njohurive të fermerëve dhe agrobizneseve duke ofruar asistencë teknike falas me qëllim përmirësimin e produktivitetit bujqësor.

Programi Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor ka një buxhet prej 491 milion lekë, ose 23% më pak se buxheti fillestar i vitit 2022. Kjo ulje vjen si pasojë e uljes së investimeve të brendshme, pas përfundimit në vitin 2022 të projektit “Godinë e rikonstruktuar dhe Stallë lopësh e ndërtuar në QTTB Fushë Krujë”.

Buxheti i planifikuar parashikohet të financojë këto produktet e mëposhtme:

- Ofrimi i rreth 48 kartave dhe paketave teknologjike me elementë të përmirësuar, të cilat synohen të adaptohen dhe aplikohen prej rreth 71.000 fermerëve;
- Informimi dhe asistimi i 131.000 fermërëve nga strukturat e ekstensionit në 4 AREB-e;
- Trajnimin çdo vit të 225 specialistëve të stafit të 4 AREB-eve;
- Asistimi i rreth 150.000 fermerëve aplikues në skemat kombëtare dhe IPARD;
- Informimi dhe trajnimi i rreth 1.200 grave fermere;
- Përmirësimi i kushteve të punës në 5 QTTB-të dhe 4 AREB-eve për realizimin e detyrave funksionale me cilësi dhe në kohë përmes projekteve të investimeve në vlerën 20 milion lekë.

- **Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore**

Me anë të këtij programi parashikohet 25 milionë lekë. Ky buxhet synon të shkojë për digjitalizimin e tokës bujqësore, përmes ngritjes së një sistemi modern të informacionit, si një instrument efektiv në realizimin e politikës, për një administrim të qëndrueshëm të tokës bujqësore, përdorimit, mbrojtjes, konsolidimit dhe zhvillimit të tregut të saj.

Baza e të dhënave do të jetë në nivel parcele dhe harte për përdorimin e tokës; tipet e tokës; përshtatshmërinë e tokës bujqësore, strukturën e tokës, pjerrësinë, ujëmbajtjen; rrezikun potencial dhe aktual të erozionit; zonimin agro-ekologjik; Skemën ujitëse; dhe Skemën kulluese (sipas tipit dhe funksionimit).

Buxheti i këtij viti do të mundësojë digjitalizimin për rreth 20 000 ha sipërfaqe të tokës bujqësore.

- **Planifikim, Menaxhim, Administrim**

Në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim me një buxhet prej 408 milion lekë do të mundësohet:

- Angazhimin kundrejt detyrimeve në kuadër të procesit të integritit, nëpërmjet përshtatjes së legjislacionit me direktivat e Bashkimit Evropian, këshillim të institucioneve zbatuese, koordinim me Komisionin European.
- Rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve planifikuese, menaxhuese dhe implementuese në institucion, për hartimin dhe monitorimin e politikave.
- Aftësim në rritje të stafit nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese në zbatim, patjetër, edhe të parimeve të barazisë gjinore.

- ***DISKUTIMET NË KOMISION***

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2023 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u përqëndruan kryesisht në:

- veprimtarinë agropërpunuese dhe mbështetjen e kësaj veprimtarie;
- koston më të lartë të prodhimit bujqësor të fermerit shqiptar në raport me vendet e rajonit;
- infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit dhe në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture nga pushteti vendor në zona të ndryshme, si dhe mbështetja e këtyre projekteve me investime në mënyrë të barabartë për të gjithë vendin;
- funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët dhe mundësinë e subvencionimit direkt të tyre pa vendosur barriera nëpërmjet kriterëve të vendosura për të qenë përfitues, si dhe procesin e disbursimit të fondeve të akorduara nga BE-ja;
- funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët për heqjen e taksës së qarkullimit për karburantin që përdoret në bujqësi;
- peshkimin dhe mbështetjen e tij, por edhe shpalljen e zonave të akuakulturës;
- uljen e buxhetit për sigurinë ushqimore dhe forcimin e kontrollit për sigurinë ushqimore;
- ndikimin e TVSH-së për uljen në produktet blegtorale;
- stimulimin e të rinjve për t'u arsimuar pranë Univesitetit Bujqësor;
- mundësinë e uljes së taksës së shitjes së tokës bujqësore; etj.

Në përgjigje të shqetësimeve të ngritura nga deputetët, Ministria Znj. Krifca sqaroi se:

- Ky buxhet pritet të materializojë vijimësinë e përgjigjes së Qeverisë shqiptare, ndaj kërkesave të vazhdueshme të fermerëve, zbatimin e prioriteteve të programit të qeverisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, e ndërthurur me sektorë të tjerë si turizmi, infrastruktura dhe shërbimet.
- Mbështetja për veprimtaritë agropërpunuese është e fokusuar tek programi IPARD, ku 45% e investimeve shkojnë në mbështetje të kësaj veprimtarie;

- Për sa i përket disbursimit të fondeve të BE-së, Shqipëria ka përparësi në raport me vendet e rajonit. Kjo është mbështetja më e lartë e akorduar për fermerët.
- Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes “Ballkani i Hapur” Shqipëria ka përparësi në krahasim me vendet e rajonit për sa i takon konkurrueshmërisë në çmimet e produkteve bujqësore. Ka një rritje prej 18.5% të eksporteve. Në periudhën janar-shtator 2022 janë eksportuar rreth 5,7 miliard lekë më shumë se 1 vit më parë, ku bujqësia dhe agroindustria kanë pasur nivelin më të rëndësishëm të rritjes në vlerë me përkatësish 25% dhe 22,7%. Këto rezultate janë me të vërtetë shumë të larta nëse konsiderojmë kushtet e vështira klimatike të këtij viti me një verë afrikane që ndikoi negativisht në kulturat e dyta në sera;
- Është punuar për garantimin e aksesit të fermerit në tregje. Në këtë kuadër po mbështeten bashkitë për ndërtimin e tregjeve të reja dhe zgjerimin e tregjeve ekzistuese. Konkretisht, për këtë vit po investohet në 5 tregje bujqësore me Bashkitë në Belsh, Bulqizë, Korçë, Tiranë dhe Zadrinë, për një fond total investimi prej 132 milionë lekë, me mbi 26 mijë përfitues të drejtpërdrejtë nga lehtësirat që këto tregje do të ofrojnë, duke filluar nga Marsi i vitit 2023;
- Siguria ushqimore është prioritet i qeverisë shqiptare dhe vijohet të investohet në kapacitete, në përmirësimin e analizave dhe kontrolleve, në gjurmueshmëri, higjenë dhe paketim. Vijon angazhimi për të modernizuar proceset përmes ndërtimit ose përditësimit të 5 sistemeve kryesore në funksion të monitorimit, analizës së të dhënave dhe ndjekjes së procedurave si për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ashtu edhe për sigurinë ushqimore. Garantimi i Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit do të mbështetet duke adresuar rekomandimet e raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë të vitit 2022, si dhe rekomandimet e DGSante dhe DGENlargment gjatë nënkomitetit zhvilluar së fundmi në Tiranë;
- Agropërpunuesit do të mbështeten për fuqizimin e kapaciteteve dhe linjave përpunuese dhe përmirësimin e infrastrukturës duke shtuar vlerën e produktit primar në vend.
- Ka pasur një ndikimin pozitiv të investimeve në ujitje-kullim. Nga viti 2013 janë investuar 23 miliardë lekë në ujitje kullim, janë rehabilituar 44 diga rezervuare, 90 km argjinatura dhe mbrojtje lumore dhe është rritur sipërfaqja ujitëse dy herë krahasuar me 2013. Ujiten sot 260 ha tokë ose 70% të potencialit ujitës në shkallë vendi.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në mbledhjen e datës 3 nëntor 2022. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministria Znj. Belinda Balluku dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Ministria Balluku u shpreh se Buxheti i vitit 2023 i akordon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë një buxhet total në vlerën 54.75 miliard lekë, nga të cilat:

- shpenzime korrente në vlerën 5.35 miliard lekë
- shpenzime kapitale në vlerën 49.39 miliard lekë, të cilat sigurohen nga financimi i brendshëm në vlerën 29.49 miliard lekë dhe financim i huaj në vlerën 19.9 miliard lekë.

Për vitin 2023 ka një rritje me 15.5% ose me 7.35 miliard lekë krahasuar me ligjin e buxhetit për vitin 2022.

Orientimet kryesore të buxhetit 2023 e në vazhdim, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë:

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjive Sektoriale, ky institucion synon të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit, të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: një portofoli të investimeve publike, si dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;
- Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimit të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese; Etj.

- **Energjia**

Ky program konsiston në krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e politikave dhe strategjive për një ecuri të qëndrueshme të sektorit të energjisë, në zbatim të programit dhe prioritetëve të qeverisë.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, ka rritje të mbështetjes buxhetore me 577.9 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Në projektligji sigurohet dhe mbështetje buxhetore për sektorin elektroenergjitik me 12 miliard lekë.

- Shpenzimet korrente janë buxhetuar në vlerën 103.3 milion lekë dhe ka një rritje të mbështetjes buxhetore në vlerën 47.9 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.
- Shpenzimet kapitale janë buxhetuar në vlerën 3.5 miliard lekë dhe ka rritje të tavanit buxhetor me 474.5 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.
- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 250 milion lekë dhe ka një rritje të tavanit buxhetor me 50 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022;

Buxhetimi i politikave ekzistuese është në vlerën 199.5 milion lekë ose 80% e tavanit buxhetor të këtij programi.

Buxhetimi i politikave të reja është në vlerën 50.5 milion lekë ose 20% e tavanit buxhetor të këtij programi.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë buxhetuar në vlerën 3.26 miliard lekë dhe ka një rritje me 480 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

- **Infrastruktura**

Transporti rrugor

Infrastruktura rrugore mbetet një ndër prioritet e qeverisë edhe për periudhën 2023-2025, dhe në projekt ligjin e buxhetit për vitin 2023 ka rritje të mbështetjes buxhetore në këtë program me 2.2 miliard lekë krahasuar me mbështetjen buxhetore në ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Ministria Balluku, bëri një paraqitje të detajuar të objekteve në zhvillim dhe atyre të reja, duke detajuar edhe financimet e tyre me kapital të huaj apo të brendshëm.

- **Autoriteti Rrugor Shqiptar**

Projektet rrugore që implementohen nga ARRSH, për vitin 2023 janë buxhetuar në vlerën 7.75 miliard lekë nga financimi i brendshëm,

Buxhetimi i politikave ekzistuese me financim të brendshëm është në vlerën 6.5 miliard lekë ose 35% të buxhetit me financim të brendshëm. Ato konsistojnë në:

- Ndërtim dhe sistemim rrugësh në vlerën 4.8 miliard lekë;
- Studim - projekttime në vlerën 125 milion lekë;
- Sinjalistikë dhe siguri rrugore në vlerën 55 milion lekë;
- Kosto Lokale dhe TVSH në vlerën 1.3 miliard lekë;
- Fondi i emergjencës në vlerën 92 milion lekë;
- Të tjera si vendime gjyqësore, shpronësime etj. janë buxhetuar në vlerën 121 milion lekë.

Buxhetimi i politikave të reja me financim të brendshëm është në vlerën 1.2 miliard lekë ose 6.5% të buxhetit me financim të brendshëm.

Shpenzimet korrente në këtë program janë buxhetuar në vlerën 2.82 miliard lekë. Ka rritje të tavanit për këto shpenzime me 10.7 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Fondet buxhetore të parashikuara për financimin dhe mbështetjen e kontratave të mirëmbajtjes rrugore, janë të pamjaftueshme për vitin 2023, dhe kërkohet një rritje e tavanit buxhetor në vlerën rreth 1.2 miliard lekë.

Transporti ajror

Prioriteti në këtë program është financimi i ngritjes së institucioneve të reja rregullatore dhe mbikqyrëse në këtë sektor të rëndësishëm.

Në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” shpenzimet korrente për këtë program janë buxhetuar në vlerën 20.3 milion lekë dhe ka një pakësim me 812 mijë lekë në raport me vitin 2022. Ndërkohë që shpenzimet kapitale janë të buxhetura në vlerën 2 miliard lekë. Ky program buxhetor nuk ka mbulim me financim të huaj.

Transporti Detar

Ky program mbulon me financim projekte të investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, ka ulje të tavanit buxhetor me 13 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, parashikohet rritje e tavanit të shpenzimeve korrente me 8.3 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 58.6 milion lekë dhe ka një pakësim të tavanit buxhetor në këtë program me 21.3 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Buxhetimi i politikave ekzistuese me financim të brendshëm është në vlerën 46.7 milion lekë ose 80% e tavanit të programit.

Buxhetimi i politikave të reja me financim të brendshëm është në vlerën 11.8 milion lekë ose 20% e tavanit të programit.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë buxhetuar në vlerën 10 milion lekë.

Transporti Hekurudhor

Ky program ka për qëllim Integrimin e Sistemit Hekurudhor Shqiptar me atë Rajonal dhe Evropian nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvilluese në fushën e infrastrukturës dhe mjeteve të transportit hekurudhor.

Ky sektor pritet të ketë zhvillim të madh në krahasim me vitet e mëparshme dhe në projektligjin e buxhetit të vitit 2023 ka rritje të mbështetjes buxhetore në këtë program me 1.67 miliard lekë krahasuar me mbështetjen buxhetore në ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet korrente në këtë program janë buxhetuar në vlerën 515 milion lekë dhe ka një rritje me 101 milion lekë.

Peshën kryesore në shpenzimet korrente e zë subvencioni i Hekurudhës Shqiptare në vlerën 490 milion lekë.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 550 milion lekë dhe ka rritje në këtë program me 150 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Buxhetimi i politikave ekzistuese është në vlerën 407 milion lekë ose 74% të tavanit buxhetor të programit, ndërsa Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë buxhetuar në vlerën 3.37 miliard lekë me një rritje të tavanit buxhetor në këtë program me 1.42 miliard lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

- **Furnizim me ujë dhe kanalizime**

Ky program financo projektet të hartuara në përputhje me prioritetet e qeverisë për reformën e ujit, mbështetur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet, Strategjinë Sektoriale, Programin Kombëtar Sektorial, grupi “Uji për njerëz” dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Në projektligjin e buxhetit të vitit 2023 ka rritje të mbështetjes buxhetore në këtë program me 926.7 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet korrente në këtë program janë buxhetuar në vlerën 422.3 milion lekë dhe ka një pakësim me 32 milion lekë. Peshën kryesore në shpenzimet korrente e zë subvencioni në vlerën 310 milion lekë,

Shpenzimet kapitale janë buxhetuar në vlerën 14.7 miliard lekë dhe ka rritje të tavanit buxhetor për këto shpenzime me 958.7 milion lekë. Kjo rritje konsiston në:

- financimi i brendshëm në vlerën 7.3 miliard lekë, me një rritje me 200 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022;
- financimi i huaj në vlerën 7.4 miliard lekë, me një rritje me 759 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Buxhetimi i politikave ekzistuese është në vlerën 6.4 miliard lekë ose 87% e tavanit buxhetor të këtij programi.

Buxhetimi i politikave të reja është në vlerën 920 milion lekë ose 13% e tavanit buxhetor të këtij programi.

Buxhetimi i politikave ekzistuese është në vlerën 7.4 miliard lekë, ose 100% e tavanit buxhetor të këtij programi

- **Mbështetje për Industrinë**

Në këtë program, në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, ka rritje të tavanit buxhetor me 33.4 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet korrente janë buxhetuar në vlerën 290.5 milion lekë dhe ka një rritje në vlerën 13.4 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 84 milion lekë dhe ka një rritje në vlerën 20 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

- **Mbështetje për Burimet Natyrore**

Në këtë program janë planifikuar fonde buxhetore të nevojshme në mbështetje të politikave lidhur me fushën e menaxhimit të burimeve natyrore që synojnë jo vetëm zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, por dhe në rritjen e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore.

Për këtë program, në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, ka rritje të tavanit buxhetor me 15 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet korrente janë buxhetuar në vlerën 239.5 milion lekë dhe ka një rritje në vlerën 15 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 91 milion lekë, për financimin e politikave ekzistuese, për institucionet:

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Sekretariati për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)
- Konservime për Albminera, Albbakër, Albkrom
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- Agjencia Kombëtare e Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera

- **Planifikim Menaxhim Administrim**

Programi “Planifikimi urban” harton, mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, kontrollin e territorit, mbetjet urbane, si dhe mbështet zhvillimin e vendit në nivel bashkie dhe rajoni, sipas fushave të përgjegjësisë; harton, mbështet, financon dhe zbaton projekte në fushat e mësipërme.

Në këtë program, në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, ka rritje të tavanit buxhetor me 15.4 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet korrente janë buxhetuar në vlerën 73.7 milion lekë dhe ka një rritje në vlerën 5.4 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 104 milion lekë dhe ka një rritje në vlerën 10 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

- **Programi i Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit**

Në këtë program, në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, ka rritje të tavanit buxhetor me 30.6 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet korrente janë buxhetuar në vlerën 540.9 milion lekë dhe ka një rritje në vlerën 30.6 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 13 milion lekë, për financimin e politikave ekzistuese, për Aparatin MIE, që lidhen me funksionimin operacional të Aparatit.

- **Mbështetje për rrjetet e Komunikacionit**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për programin “Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit” është e angazhuar plotësisht për të avancuar me zhvillimin e infrastrukturës digjitale broadband, si dhe prioritet ka realizimin e qëllimit dhe arritjen e objektivave të politikës së programit, për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative, rritjen e standardeve dhe performancës së punës së tyre.

Në këtë program në projektligjin e buxhetit të vitit 2023, ka rritje të tavanit buxhetor me 96 milion lekë, krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2022.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë buxhetuar në vlerën 100 milion lekë.

Shpenzimet kapitale me financim të Huaj janë buxhetuar në vlerën 20 milion lekë.

- ***DISKUTIMET NË KOMISION***

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2023 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, u përqëndruan kryesisht në:

- mbulimin me financim për projekte të ndryshme infrastrukturore, si dhe proporcionaliteti gjeografik i projekteve infrastrukturore;
- problematikat në furnizimin me ujë dhe projektet në infrastrukturë e ujësjellës – kanalizime dhe përfitimi i zonave rurale prej tyre;
- investimet në sektorin e energjisë dhe diversifikimin e burimeve të energjisë;
- ecurinë e skemës së rimbursimit për qytetarët që vendosin paneleve diellore për përdorim vetjak;
- çmimi i energjisë dhe aplikimi i fashës prej 800 këh për konsumatorin;

Ministria Znj. Balluku, iu përgjigj pyetjeve të deputetëve duke i sqaruar për të gjitha shqetësimet e ngritura prej tyre. Konkretisht:

- në lidhje me shpërndarjen e investimeve në infrastrukturë sqaroi se po investohet në të gjithë vendin qoftë në infrastrukturë e qoftë në furnizimin me ujë;
- në lidhje me çmimin e energjisë elektrike, sqaroi se për konsumatorin çmimi nuk është rritur. Ndërsa vendosja e fashës në rast se ajo do aplikohet prek një numër shumë të vogël konsumatorësh në raport me totalin e abonentëve;

- për sa i përket rimbursimit për vendosjen e paneleve diellore, sqaroi se po punohet për ta shtuar fondin e mbështetjes së vendosjes së paneleve diellore me grante të BE-së;
 - Gjithashtu, iu përgjigj interesit të deputetëve në lidhje më ecurinë e projekteve të ndryshme në infrastrukturë, energji, furnizime me ujë; industri nxjerrëse, etj.
- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 22 nene.

- ***Përfundime***

Gjatë diskutimeve, deputetët, pasi u njohën me nevojat buxhetore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe për ato çështje për të cilat u ngrit nevoja për t'u mbështetur me fonde shtesë apo rregullim i brendshëm i tyre, u shprehën të gatshëm që t'i trajtojnë ato gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2023”.

Pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2023 për secilën nga ministritë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, Komisioni me me të gjitha votat e të pranishmëve u shpreh dakord në parim me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”.

Laert DURAJ

Arben PËLLUMBI

Relator

Kryetar